

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Fondit të pensioneve i mungon rreth 1 miliard euro në vit, Velkovski garanton pagesën e pensioneve
ADRESA	https://albeu.com/maqedoni/fondit-te-pensioneve-i-mungon-rreth-1-miliard-euro-ne-vit-velkovski-garanton-pagesen-e-pensioneve/1012067/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 08:00:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 07:56:04 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4c103bc26f5bb064160c59c7f197fbc9bd4a7bba1be4085a2200bc370fe3756d
TEKSTI	eb336d6aa5cc81756e8710f18c306fcd2ae00c2baf351b0c3609625837dce7e4
PAMJA	6ace0feb18d0710179a5f741810b780f632a0e9edc474c19bab6fc950a6bcae9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6f1889f03c54be91dec35474e1aade18b55fde6fa28d3dddec7f53817d71a192c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9887a58f034e5892caf63e36cbe81dcf86c1b224001923b84c66783530d965e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6f1889f03c54be91dec35474e1aade18b55fde6fa28d3dddec7f53817d71a192c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fondit të pensioneve i mungon rreth 1 miliard euro në vit, Velkovski garanton pagesën e pensioneve



Për të realizuar pagesën e pensioneve, Fondit shtetëror të pensioneve i mungon çdo vit rreth një miliard euro. Ministri i Politikës Sociale, Gjoko Velkovski, në një intervistë për "360 Gradë" në MRT 1, konfirmoi se ky hendek financiar plotësohet me mjete nga buxheti i shtetit.

Për pensionet nevojiten rreth 2.4 miliardë euro në vit, kurse nga kontributet e të punësuarve mbledhen afërsisht 1.4 miliardë euro. Sipas Velkovskit, shteti aktualisht siguron rreth 60 miliardë denarë në vit për të mbuluar mungesën financiare të Fondit të pensioneve.

Mbështetja që Fondi mori nga buxheti gjatë vitit 2023 ishte rreth 510 milionë euro. Kjo tregon se, brenda tre vjetësh, shuma e nevojshme nga Buxheti pothuajse është dyfishuar. Në shtimin e shpenzimeve ka ndikuar edhe rritja lineare e pensioneve, e cila në total arriti në 7,000 denarë.

Ministri tha se kjo ndërhyrje duhej të ndërmerrej për shkak të të ardhurave të ulëta të një pjese të pensionistëve. Mes faktorëve të tjerë që ndikojnë në deficit, ai përmendi largimin jashtë vendit të popullsisë në moshë pune, luhatjen e fuqisë punëtore dhe numrin e lartë të të punësuarve që figurojnë me pagë minimale.

Duke siguruar se pensionet nuk janë në rrezik, Velkovski deklaroi se "shteti është garantuesi dhe pensionet do të paguhen në kohë". Ai paralajmëroi reforma që synojnë fuqizimin e sistemit, por nuk dha ndonjë përlogaritje financiare apo afat të përcaktuar se kur mund të zvogëlohet varësia e Fondit nga buxheti shtetëror.

Ndërkohë, Qeveria po analizon mundësinë e ndryshimeve edhe në shtyllën e dytë pensionale. Një nga opsionet është që qytetarët të mund të vendosin nëse dëshirojnë të mbeten vetëm në fondin shtetëror apo të vazhdojnë pagesat edhe në fondet private./Telegrafi/

të fundit /



Fondit të pensioneve i mungon rreth 1 miliard euro në vit, Velkovski...



Juventus i vë në pikëpyetje Spallettin, Antonio Conte shihet ...



Man United në ofensivë për mbrojtësin e Barcelonës, Carrick i...



Edmond Ahmeti emërohet Sekretar i Përgjithshëm i KQZ-së



Mustafa flet për takimin me Kurtin dhe propozon formulën V...



Trump përmbys kursin klimatik të Bidenit, hap rrugën për më shumë...



Ekipi që mbron Jakup Krasniqi në Hagë



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Shtuar më 15.09.2026 09:56

Tags: [Fondi pensional i maqedonisë](#), [Pensionet në maqedoni](#), [Pensionistët e maqedonisë](#)



Sela: Pas zhgënjimeve nga koalicionet, po bëhemi gati të garojmë të vetëm



QMK: Asnjë zjarr aktiv në Maqedoni



ASH zyrtarizon mbështetjen për kandidatin e AKI-së në Bërvenicë



Dimitrieska-Kočoska: Investimet me mbështetjen e BE-së po modernizojnë...



Kodi Zgjedhor rikthehet në tryezën e diskutimeve në Kuvendin e Maqedonisë ...



Maqedonia e Veriut rikthehet në Eurovision në vitin 2027 pas pesë vites...



QMK: Nga 14 zjarret e raportuara, vetëm ai pranë Borinos vijon të jetë aktiv



Nikollovski: Luftë e pakompromis ndaj krimit në Doganë, të dyshuarit do t...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.